



Buxhetimi i kompjuterizuar për OJQ

(Resource ID: 333)

Vlora Berisha

vlora.berisha(at)unhz.eu

This teaching resource is allocated to following University:

UPHZ - University of Peja "Haxhi Zeka"

Institution:

University Haxhi Zeka

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/333.Buxhetimi-i-kompjuterizuar-pr-OJQ>



Punë
individuale
Puna në grup



5 deri në 10
studente



Deri në 3 njësi
leksionesh



Lidhja me Web
e nevojshme



Anglisht, Shqip

Materiali mesimor përfshin informacione lidhur me menaxhimin financiar të grant projekteve. Materiali është i përshtatshëm për të gjithë punonjësit e OJQ-ve të cilet janë përgjegjes për ndertimin dhe zbatimin e projekteve apo ndertimin e buxhetit global të organizates.

Menaxhimi i grant projekteve është një detyrë sfiduese që kërkon një menaxhim efikas dhe funksional. Menaxhimi korrekt i anës financiare është qenësore për suksesin e projektit. Ne ditet e sotme, procesi i buxhetimit është i kompjuterizuar kështu që në vend që të jetë preokupim kryesor ana matmatikore (manipulimi me numra), punonjësit e NGO-ve që janë përgjegjes për projekte konkretisht për përgaditjen e buxhetit mund të fokusohen dhe involvohen më shumë në procesin e planifikimit, sepse buxhetimi i kompjuterizuar nga aspekti matmatikorë mund të korigjohet me

shpejte dhe me lehte.

Prej këtij materiali studimor punonjësit e NGO-ve, do të kenë mundësi të rrisin aftësitë e tyre në implementimin e një pjese të rëndësishme të grant projekteve sic është buxheti, duke u nisur nga fakti se suksesi i përgjithshëm i projektit matet jo vetëm nga rezultatet e arritura, por edhe nga mënyra e shfrytëzimit të mjeteve financiare në dispozicion. Përgaditja e buxhetit përmes Excelit është shumë më efikase sesa përdorimi i kalkulatorit apo përgaditja manulale (me dorë) e buxhetit. Po ashtu e-buxhetimi përmes përdorimit të web teknologjisë tërësisht e automatizon zhvillimin e parashikimit të buxhetit të organizatës.

Përmes shembujve të ilustruar, punës në grupe dhe diskutimeve, rasteve të studimit, aktiviteteve praktike të zgjedhjes së problemeve studentet do të aftësohen në përpilimin e buxhetit sipas teknikes së bazuar në aktivitete, përgaditjen e buxhetit sipas formateve (shabllonit) që kërkon donatori, përgaditjen dhe parashikimin e rrjedhjes së parasë së projektit, identifikimi i llojeve të ndryshme të qasjeve të buxhetit dhe alternative të zgjedhjes së buxhetit.

Moduli trajnues do të zhvillohet brenda tre diteve ku të përfshijnë:

Dita e parë: Prezantimin e modulit (kuptimin e buxhetit dhe planifikimit financiar)

Dita e dytë: Shembujt të praktikave të mira të krijimit të buxhetit, puna në grupe e studenteve, puna individuale e studenteve, pas punës në klasë studentet do të punojnë individualisht në krijimin e buxhetit lidhur me aktivitetet të ndryshme (p.sh. projekti për organizimin e panairit të punës, projekti për rritjen e vetediesimit të grave për dhunen në familje, projekti për promovimin e një produkti etj.), secili student në mënyrë individuale do të përcaktohet për një aktivitet dhe do të përpilojë buxhetin dhe do të tregojë si do të bëjë menaxhimin financiar të atij aktiviteti, si do të'i klasifikojë shpenzimet, si do të ndajë linjat buxhetore.

Dita e tretë: Vizitë studimore, studentet do të shohin se si NGO-të e sukseshme të cilat kanë realizuar projekte të shumta e përgadisin buxhetin, do të shohin se si lehtësohet puna e krijimit të buxhetit me anë të programeve të avancuara të kontabilitetit.

Dita e katërt- Konkluzione, (Përmbledhja e pikave kyçe të mësimin, planifikimi i punës, Vleersimi dhe përfundimi)

Mjetet e mësimdhënies



Mini-projekt për studentët Material i shkruar

Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Stafi i NGO-ve i cili është përgjegjes për implementimin e projekteve do të perfitoj njohuri të konsiderueshme dhe kuptojë rëndësin e përgaditjes së buxhetimit të kompjuterizuar që ka në rritjen e lehtësis në menaxhimin financiar dhe krijimin e burimeve financiare të qëndrueshme

Staf i NGO-ve do të viziton NGO-të të cilat kanë realizuar projekte me sukses dhe do të mësojnë nga përvojat e tyre më të mira. NGO-të do të mund të krijojnë lidhje dhe të bashkëpunojnë në projektet e ardhshme dhe po ashtu shkëmbejnë eksperiencat e tyre .

Pika e forte

- Njohje të teknikave të ndryshme të perpilimit të buxhetit
- Aftësim në përgaditjen e buxhetit sipas shabllonit / formatit të donatoreve të ndryshëm dhe master buxhetit
- Stafi i NGO-ve i cili është përgjegjes për implementimin e projekteve do të perfitoj njohuri të konsiderueshme dhe kuptojë rëndësinë e përgaditjes së buxhetimit të kompjuterizuar.

Pika e dobët

- Mosgadishmeria e punonjësve NGO-ve që të ndryshojnë praktikën tradicionale të përgaditjes së buxhetit

Rezultatet e të mësuarit

- Zhvillimin e buxhetit (përmes pesë hapave : Caktimi i personit përgjegjës për përgatitjen e buxhetit, krijimi i kalendarit buxhetor, përgatitja e procesit buxhetor, ndërtimi i buxhetit dhe monitorimi i buxhetit)
- Mësim praktikave të mira të perpilimit të buxhetit përmes përdorimit të teknologjisë së avancuar .
- Përpilimin e Buxhetit sipas teknikes së bazuar në aktivitete.
- Ndërtimin e buxhetit sipas formatit të donatorit
- Kuptimin e procesit të planifikimit financiar

Lidhja për qëndrueshmëri

– Mundësi për rritjen e qëndrueshme të burimeve të financimit përmes menaxhimit të mirë financiar

Njohuri paraprake

Asnje lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

Përpjekjet e përgatitjes

Te□ pakta

Përshkrimi i përpjekjeve të përgatitjes

– Përgatitja për ligjeratë : 4 ore

Aksesi

Free

Gjykimi / vlerësimi

Prezantimi i planifikimit buxhetor

Kreditim/Çertifikatë

Jo

Burime dhe lidhje

– Colin Drury. "Management Accounting for Business", 4th Edition. USA 2009.

– Technical Assistance for Civil Society Organizations Kosovo Office. "Practical Manual for Grants – Financial Related Issues"

– http://ec.europa.eu/europeaid/implementation/practical_guide/index_en.htm

– http://international.cengage.com/emea/drury_6e/student/realworldviews/realworldboxes/Real-15.pdf

-
https://www.academia.edu/1920616/The_Use_of_Computer_in_Budgetary_Control_at_Local_Government_Level

Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.